



Data: 11. 02. 2019

Ref.: 187/190

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Neni 7 dhe Neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet pjesërisht kërkesa e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Nr.1494/18H, datë 31.10.2018 për riakreditim/akreditim të programeve të studimit:
 - Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS;
 - Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS; dhe
 - Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsy etimi

Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, (tash e tutje Universiteti), ka parashtruar kërkesë (Nr.1494/18H, datë 31. 10. 2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit si në vijim: Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS; Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS; Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS; Menaxhim Biznesi, BSc, 180 ECTS (Në gjuhën boshnjake); Menaxhim Biznesi MSc, 120 ECTS (Në gjuhën boshnjake); Menaxhim Biznesi, BSc, 180 ECTS (Në gjuhën shqipe); Menaxhim Biznesi MSc, 120 ECTS (Në gjuhën shqipe); Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis, BSc, 180 ECTS; Menaxhim në Mjedis dhe Turizëm, 120 ECTS; Juridik i Përgjithshëm, LLB, 240 ECTS; E Drejta Penale, LLM, 60 ECTS; E Drejta Ndërkombëtare dhe Evropiane, LLM, 60 ECTS; Teknologji Ushqimore, BSc, 180 ECTS; Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc, 180 ECTS; Edukim Artistik në Interpretim, BA, 240 ECTS, dhe Edukim Muzikor, MA, 60 ECTS. Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e këtij institucioni.

Bazuar në pikën 1.2 të neni 10 të UA për Akreditim, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili

bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit, Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS; Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS; Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28. 09. 2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

1. Për programin e studimit: *Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Universiteti i Pejës ka paraparë këta persona: Ibish Mazreku, Edmond Beqiri dhe Florin Peci.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.* Programi i studimit *Menaxhim Biznesi, PhD, ka 180 ECTS*, dhe rrjedhimisht duhet ti ketë të paktën tre PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky Universitet për këtë program të studimit, u konstatua që nuk ka staf të mjaftueshëm për fushën e programit të studimit siç kërkohet në nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga ky institucion, u konstatua si në vijim: Ibish Mazreku është PhD në Fushën e Sigurimeve, Edmond Beqiri, PhD në fushën Informatikës së Aplikuar, dhe Florin Peci PhD në Shkenca Ekonomike. Derisa programi i studimit është Menaxhim Biznesi, ndërsa në anën tjetër asnjëri nga bartësit e këtij programi nuk i përket fushës së menaxhmentit, dhe duke marrë për bazë faktin që bëhet fjalë për studime të doktoratës, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit dhe bazuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim ta refuzoi aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Menaxhim Biznesi, PhD, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Universiteti i Mitrovicës ka paraparë këta persona: Nazmi Hasanaj, PhD në Bujqësia dhe Mjedis, dhe Ilir Morina, PhD në Shkenca Bujqësore, dhe Naser Bajraktari, PhD në Shkenca e Kimisë.

Sipas paragrafit të fundit të nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“...për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Programi i studimit *Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, ka 180 ECTS*, dhe rrjedhimisht duhet ti ketë të paktën tre PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti i Pejës për këtë program të studimit, u konstatua që Ilir Morina nuk mund të jetë bartës i këtij programi, pasi që i njëjti ka marrëdhënie të rregullt të punës në Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, dhe njeherit mban edhe pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në këtë institucion.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik siç është përcaktuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të referuar me lartë, ta refuzoi aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Agromjedis dhe Agroekologji, BSc, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS*, si bartës të këtij programi Universiteti i Pejës ka paraparë këta persona: Ismajl Cacaj, PhD në Shkenca Bujqësore, në fushën e Mbrojtjes së Bimëve, dhe Agim Rysha PhD në Shkenca Bujqësore.

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: “...kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuara sipas statutit të IAL) për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”, ndërsa sipas pikës 5.3.5 të Nenit 26 kërkohet që: “Nëse programi i studimit përmban edhe specializime, atëherë numri i specializimeve duhet të jetë në përputhje me numrin e stafin akademik të rregullt në atë program i cili ka kompetencën e duhur për ato specializime”

Programi i studimit *Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS*, ka dy specializime/profile a) Prodhim Bimor dhe b) Bioteknologji Ushqimore dhe rrjedhimisht duhet ti ketë të paktën tre PhD nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, u konstatua që nuk ka staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për fushën e programit të studimit siç kërkohet në nenin 26, pika 5.3.4 dhe 5.3.5 të UA për Akreditim. Po ashtu aplikacioni për akreditim të Programit Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore nuk plotëson kërkesat e Nenit 10, paragrafi 1.3.3 në varësi të nenit 26 paragrafi 4, i cili përkufizon se: “Programet studimore të institucionit duhen të jenë të krahasueshme me standardet e programeve ekuivalente studimore në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë”. Programi i propozuar Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, nuk është i krahasueshme në asnjë rast me Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, sepse përmban dy fusha të ndryshme që nuk janë komplementare.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik dhe siç është përcaktuar në nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të referuar me lartë, ta refuzoi aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Prodhim Bimor dhe Bioteknologji Ushqimore, MSc, 120 ECTS*.

Këshillë juridike: : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë sipas Nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

